



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY**

**DEPARTAMENTI I TREGTISË
DEPARTAMENT TRGOVINE
DEPARTAMENT OF TRADE**

SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS / 2011

Shkëmbimet tregtare të Kosovës gjatë vitit 2011 arritën vlerën prej 2.7 miliard Euro tregues ky që është më i lartë se në vitin 2010 për 14.7%.

Sa i përket importeve ato shënuan vlerën mbi 2.4 miliard Euro vlerë më e lartë për 15.9% në raport ndaj vitit 2010.

Mallrave e eksportuara kanë shënuar vlerën prej 313 milion Euro rritje prej 6.5%.

Për këtë periudhë kohore mbulimi i importit nga eksporti është 12.6%.

Tregtia me vendet Bashkimin Evropian dhe vendet e rajonit (CEFTA) përbëjnë pjesën dërmuese të tregtisë së jashtme të Kosovës duke mbuluar 72.7% të tregtisë së përgjithshme.

QARKULLIMI TREGTAR I KOSOVËS ME VENDET E BE- s – Referuar treguesve të importit dhe eksportit të përgjithshëm të Kosovës shihet se BE zë një vend të rëndësishëm në bilancin tregtar të vendit. Kështu, sipas destinacionit (grup vendeve) gjatë vitit 2011, qarkullimi tregtar me BE përbën 38.5% të tregtisë së përgjithshme e cila arriti vlerën rreth 1.07 miliard € tregues ky që është më i lartë se nga viti 2010 për 12.9 %.

Nga kjo vlere e importit është mbi 940 mil euro ose 37.9 për qind nga vlere totale e importit me rritje prej 14.5 për qind ne raport me periudhën e njëjtë te vitit 2010.

Brenda vendeve te BE-se kemi një dominim te importeve nga vendet si :

Gjermania me vlere mbi 292 mil/€ ose 11.8% e importeve te përgjithshme ne Kosove, 31% e importeve totale nga BE si dhe rritje për 6.3% nga viti paraprak.

Si vend tjetër me rëndësi ne importet e Kosovës zënë edhe Italia vlere e importeve prej 157 mil/€ ose 6.3% e importeve te përgjithshme rritje prej 56.4%, Greqia me vlere te importeve për 103 mil/€ ose 4.2% e importeve te përgjithshme rënie prej 0.7%.

Sllovenia me vlere te importeve për 71 mil/€ ose 2.9% e importeve te përgjithshme me rritje prej 4.5%.

Po ashtu importet nga Bullgaria shënuan vlerën prej 50 mil/€, 2% e importeve te përgjithshme me rritje prej 43% etj.

Mirepo sa i perket volumit te eksporteve sipas destinacionit edhe gjatë vitit 2011 pjesa më e madhe eksporteve te Kosovës ka qenë e orjentuar drejt vendeve te BE –se, duke arritur ne 135 mil€ ose 43.2% e totalit te eksporteve me një rritje prej 2.9% kundrejt vitit 2010.

Vendet me peshen me te madhe te eksporteve te Kosoves ne/BE:

Italia është si vend me atraktiv për eksport, duke mbuluar 62% te Eksporteve të Kosovës ne BE si dhe 26.7% e eksporteve te përgjithshme, rritje për 4.4%.

Pas Italis, Gjermania renditet e dyta duke mbuluar 17% të eksporteve totale në BE dhe 7.5% te eksporteve te përgjithshme me rritje për 56%. Pastaj renditet Sllovenia me 4.4% te eksporteve totale ne BE dhe 1.9% e eksporteve te përgjithshme, rritje per 10.6%. Te tri vendet e cekura me larte(Italia, Gjermania dhe Sllovenia) mbulojne 84% e eksporteve totale ne BE.

Mirepo vlene te ceket se gjate vitit 2011 kemi nje renie te madhe te volumit te eksporteve ne drejtim te Belgjikes për 55.6% dhe Bullgaris për 87.8%, vende te cilët më parë kanë mbuluar relativisht një pjesë te vlerës së eksporteve ne drejtim të vendeve te BE-se.

TREGTIA E JASHTME E KOSOVËS ME VENDET ANËTARE TË CEFTA-s

Duke parë ecurinë e qarkullimit tregtare me vendete CEFTA-s e cila arrin vlerën prej 953 mil/€ shihet se gjatë vitit 2011 kemi rritje të saj prej 9.6% ndaj vitit 2010. Nga kjo vlera e importit është mbi 871 mil/€ ose 35% nga vlera e përgjithshme e importit. Ky tregues tregon rritje të importit me këto vende për 9.1% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Eksportet me destinacion ndaj vendeve të rajoni anëtar në CEFTA kapën vlerën mbi 82 mil/€ ose 26.3% nga vlera totale e eksporteve, vlerë e cila tregon ecuri pozitive nga se është më e lartë për 16% krahasuar me vitin 2010.

TREGJET KRYESORE EKSPORTUESE DHE IMPORTUESE, CEFTA/ 2011

Maqedonia ende mbetet partneri i rëndësishme tregtare i Kosovës si në import ashtu edhe në eksport, vendi i cili mbulon 41.8% të importeve të përgjithshme dhe 37% të eksporteve të përgjithshme në nivelin e vendeve anëtar pjesëmarrës në CEFTA dhe 14.7% në mbulimin e importeve dhe 9.8% në mbulimin eksportit të përgjithshëm të Kosovës.

Mirëpo, vitit 2011 shënoi rritje të konsiderueshme të importeve të Kosovës nga Maqedonia për 15.3% më të lartë në raport me vitin 2010.

Megjithatë përveç rritjes së importeve nga Maqedonia kemi edhe tendencën e rritjes së eksporteve në drejtim të këtij vendi për më të lartë se 16.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shqipëria si partner tregtar me rëndësi është destinacion i parë për eksportet e Kosovës në nivelin e vendeve të CEFTA-s, duke mbuluar 41.7% të eksporteve në raport me vendet e rajonit pjesëmarrës në CEFTA dhe 11% pjesëmarrje në eksportet e përgjithshme. Importet nga Shqipëria mbesin ende në nivel të ulët në raport me disa vende të rajonit e cila mbulon 11% të importeve të përgjithshme të CEFTA-së dhe 3.9% pjesëmarrje në importet totale të Kosovës.

Mirëpo, vlen të theksohet se importet nga Shqipëria shënuan rritje për 39.4% në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2010.

Për kundër kësaj shkëmbimet tregtare me **Serbin** paraqesin një ritëm tjetër tregtare e cila u karakterizua me rënien e importit në nivelin e importit të përgjithshëm për 2% në raport me periudhën

e njëjte te vitit 2010 dhe rritje te shumëfishë te eksporteve për 82% apo e shprehur ne vlere nga 3.8mil/€ ne 6.9 mil/€. Importet nga Serbia përbejnë rrethe 10.3% te importeve te përgjithshme te Kosovës dhe 2.2% te eksporteve te përgjithshme.

PARTNER TJERË ME RËNDËSI NË QARKULLIMIN TREGTARE TË KOSOVËS

Si partner tjerë me rëndësi ne qarkullimin tregtare te Kosovës zënë edhe këto vend si:

Kina me një pjese te konsiderueshme ne eksportet e Kosovës prej 9% me rritje për 90.8% dhe importe prej 6.8% me rritje për 25.8%.

Turqia – përmban 2.4% e eksporteve te përgjithshme me një rënie prej 20 % dhe importet nga ky vend janë 7.4% nga importet totale me rritje prej 23%.

India – një pjesë e konsiderueshme e eksporteve te Kosovës është e destinuar ne Indi e cila kape shumën prej 13mil/€ ose 4% pjesëmarrje ne eksportin total dhe me një pjesëmarrje te vogël ne importe prej 0.33%.

STRUKTURA E EKSPORTEVE

Ne lidhje me strukturën e eksporteve ato ende mbesin te njëjta, janë kryesisht ne formën e lëndës se parë dhe produkteve te përfunduara. Eksportet janë te dominuar nga metalet baze - artikujt prej tyre si dhe produktet minerale te cilat gjate vitit 2011 kane mbuluar 73 % te totalit te eksportit.

Kështu, eksporti i metaleve është zëri kryesor ne eksportet e Kosovës ku vlen te theksohet veçmas kaputujt Giza dhe çeliku, artikujt prej gize dhe çeliku, bakri dhe artikujt prej bakri .

Një tjetër komponent i rendesisheme eksporti është Makineritë dhe pajisjet mekanike, pjesët e tyre qe mbulon 4.8% e eksporteve te përgjithshme, pastaj ushqimet e përgatitura dhe pijet/alkoolet qe kane ndikim me 4.1% ne eksportet e Kosovës me rritje prej 12%. Me pjesëmarrje prej 4% ne eksportet e përgjithshme janë edhe produktet bimore, rritje prej 3.4%.

Mirëpo vlen te theksohet se kemi një rritje te madhe ne përqindje edhe pse me vlere te vogël ne strukturën e eksporteve si plastike, gome dhe artikuj prej tyre për 54%, (mbulim 4% e eksporteve totale), tekstil dhe artikuj tekstili rritje për 33%, me mbulim prej 3.5%.

Referuar, **grup – mallrave** dhe kapitujve sipas sistemit te harmonizuar, ecuria e vëllimit te eksportit gjate vitit 2011 paraqitet si me poshtë:

- **Grupi i produkteve ushqimore**, qe përbehet kryesisht nga produktet bujqësore – blegtorale e te industrisë ushqimore (1 – 24 Kapitujt e pare te HS) është 8.3% ndaj totalit te eksporteve te Kosovës duke arritur vlerën prej 25 mil/€.

Te ky grup i produkteve ushqimore kane dominuar: drithërat: pijet, alkoolet dhe uthulat: produktet e industrisë bluajtëse: Përgatitje prej zarzavateve, frutave apo pjesëve të tjera: Zarzavatet(perimet): etj.

- **Grupi i produkteve jo – ushqimore** (industriale 25 – 99 kap. HS) është 91.7% ndaj totalit te eksporteve duke arritur vlerën prej 287mil/€. Përbërja e importeve te mallrave jo – ushqimore ka qene e dominuar nga: Giza dhe çeliku: Xeheroret, zgjyra dhe hiri: Bakri dhe artikujt prej bakri etj.

Produktet me te eksportuara, HS- 6 shifror/ 2011 - nëse i referohemi te dhënave për eksportet sipas produktit HS- 6 shifror, kuptojmë që fero nikeli mbulon 42.8% të eksporteve totale, kthime dhe mbetje prej gize dhe çeliku e cila mbulojnë 7% të eksporteve totale. Produktet e tjera më të eksportuara janë energjia elektrike, mbetjet dhe kthimet e bakrit, xeherore dhe koncentre plumbi, miell gruri, lëkurët e gjedheve të tëra etj.

Eksportet e Kosovës 2010 - 2011, (vlera.000€)

<i>Seksionet sipas sistemit te Harmonizuar (HS)</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>ndryshimi</i>	<i>ndryshimi ne %</i>
01 Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	927	435	-492	-53.1
02 Produkte bimore	12,137	12,554	417	3.4
03 Yndyrëra	100	44	-56	-56.0
04 Ushqime të përg. pije dhe duhan	11,408	12,804	1,396	12.2
05 Produkte minerale	38,756	39,231	475	1.2
06 Produkte të industrisë kimike	1,323	2,209	886	67.0
07 Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	8,030	12,378	4,348	54.1
08 Lëkurë dhe artikuj prej tyre	9,650	9,298	-352	-3.6
09 Druri dhe artikuj druri	1,248	1,606	358	28.7
10 Letër dhe artikuj prej letëre	1,042	1,382	340	32.6
11 Tekstil dhe artikuj tekstili	8,329	11,090	2,761	33.1
12 Veshmbathje të këmbëve	49	85	36	73.5
13 Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	1,402	1,145	-257	-18.3
14 Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	27	22	-5	-18.5
15 Metale bazë dhe artikuj prej tyre	185,159	190,060	4,901	2.6
16 Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	10,722	15,079	4,357	40.6
17 Mjetet e transportit	1,468	1,018	-450	-30.7
18 Instr.optike,mjekësore,fotog.,muzikore etj.	357	530	173	48.5
19 Armët dhe municionet	253	0	-253	-100.0
20 Artikuj të ndryshëm të prodhuar	1,644	2,043	399	24.3
21 Veprat e artit	0	96	96	#DIV/0!
Gjithsej	294,030	313,108	19,078	6.5

Burimi: ASK,(preliminare)

STRUKTURA E IMPORTEVE - mbetet e ngjashme me vitin e kaluar, importet dominohen nga kategoria e produkteve minerare, ushqime te përgatitura, pije dhe duhan si dhe kategoria e makinerisë dhe pajisjeve që kapin shumën e një vlere prej 1.1 miliard / € ose 44.7% të importeve totale.

Referuar, **grup – mallrave** dhe kapitujve sipas sistemit te harmonizuara, ecuria e vëllimit te importit gjate vitit 2011 paraqitet si me poshtë:

- **Grupi i produkteve ushqimore**, qe përbehet kryesisht nga produktet bujqësore – blegtorale e te industrisë ushqimore (1 – 24 Kapitujt e pare te HS) është 22.6% ndaj totalit te importeve ne Kosove duke arritur vlerën prej 560 mil/€ me një rritje ndaj vitit 2010 për 17.5%.

Te ky grup i produkteve ushqimore kane dominuar: pijet, alkoolet dhe uthulat,duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhani, mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit, drithërat, sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij, produktet bulmetore etj.

- **Grupi i produkteve jo – ushqimore** (industriale 25 – 99 kap. HS) është 77.4% ndaj totalit të importeve duke arritur vlerën prej 1.9 miliard/€. Përbërja e importeve të mallrave jo – ushqimore ka qene e dominuar nga: Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale: mjetet e transportit të ndryshëm dhe pjesët e saj: makineritë dhe pajisjet mekanike, pjesët e tyre: giza dhe çeliku: makineri dhe pajisje elektrike dhe pjesët e tyre etj.

Por si produktet të veçanta më të importuara në Kosovës bazuar ne sistemin e harmonizuar HS- 6 shifror janë: nafta që përbënë 10.7% të importeve totale, hekuri (ose shufrat e çelikut) 2.5%, mjetet e transportit 2.4%, vajrat e lehtë dhe preparatet 2.3%, cigare që përmban duhan 2.3%, energji elektrike 2.2%, Çimento portland 1.6%, Grurë (grurë i forte) 1.4% etj.

Importet ne Kosovë 2010 - 2011, (vlera.000€)

<i>Seksionet sipas sistemit të Harmonizuar (HS)</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>ndryshimi</i>	<i>ndryshimi ne %</i>
01 Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	87,016	97,363	10,347	11.9
02 Produkte bimore	108,491	136,843	28,352	26.1
03 Yndyrëra	19,296	22,024	2,728	14.1
04 Ushqime të përg. pije dhe duhan	261,677	303,860	42,183	16.1
05 Produkte minerale	413,775	538,117	124,342	30.1
06 Produkte të industrisë kimike	146,614	177,824	31,210	21.3
07 Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	108,097	137,464	29,367	27.2
08 Lëkurë dhe artikuj prej tyre	3,821	5,022	1,201	31.4
09 Druri dhe artikuj druri	48,982	53,837	4,855	9.9
10 Letër dhe artikuj prej letër	49,314	47,035	-2,279	-4.6
11 Tekstil dhe artikuj tekstili	71,567	88,464	16,897	23.6
12 Veshmbathje të këmbëve	24,338	27,518	3,180	13.1
13 Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	84,705	91,147	6,442	7.6
14 Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	1,440	1,777	337	23.4
15 Metale bazë dhe artikuj prej tyre	189,964	228,005	38,041	20.0
16 Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	288,238	267,632	-20,606	-7.1
17 Mjetet e transportit	142,062	155,343	13,281	9.3
18 Instr.optike,mjekësore,fotog.,muzikore etj.	24,939	25,069	130	0.5
19 Armët dhe municionet	3,338	1,347	-1,991	-59.6
20 Artikuj të ndryshëm të prodhura	61,712	61,884	172	0.3
21 Veprat e artit	141	12,033	11,892	8,434.0
Gjithsej	2,139,526	2,479,608	340,082	15.9

Burimi: ASK, (preliminare)